

<p>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</p>	<p>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</p>	<p>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</p>
--	---	---

ASC -09-0016

Në kontestin e

[REDACTED], Komuna e Deqanit

Paditësi

Vs

Korporata Energjetike e Kosovës, Ndërmarrje Publike, Pejë

E përfaqësuar nga **[REDACTED]**, Pejë

E Paditura/Apeluesi

Kolegji i Ankimeve pranë Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Kryesues i Kolegjit, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, sipas ankimit kundër aktgjykimit të Trupit Gjykses të datës 2 prill 2009, SCA-08-0072, , pas seancës së shqyrtim-votimit të mbajtur me 17 qershor 2010 lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Ankimi i të Paditues kundër Aktvendimit të Trupit Gjykses, SCA-08-0072 të datës 2 prill 2009, refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Me rastin e ankimit pika III e diapozitivit të aktgjykimit të ankimuar DHPGJS-së eliminohet.**
- 3. E Paditura/Apeluesi obligohet që ti paguajë në DHPGJS shpenzimet e përkthimit dhe shpenzimet e procedurës ankimore shumë e përgjithshme prej 166 Euro.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 12 gusht 2004, Paditësi ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale të Deqanit kundër të paditues, Ndërmarrjes Publike, [REDAKTUAR]. Në padinë e tij, Paditësi ka kërkuar nga Gjykata Komunale që ta obligojë të padituren për dhënien e kompensimit në shumën prej 21.500 Euro (në përkthimin në Anglisht shuma totale e dëmit 21,200 Euro, në Shqip 21,500 Euro) për shkak të djegies së shtëpisë së tij "nga rryma elektrike, e cila në at moment ka qenë më e lartë sesa zakonisht dhe përpara djegies së shtëpisë ka patur ndërprerje të vazhdueshme të rrymës në çdo dhjetë minuta". Gjatë procedurës në Gjykatën Komunale kërkesa për dëme të shtëpisë kishte zbritur në 6, 564 Euro.

E paditura e ka kundërshtuar tërë padinë duke thënë se nuk janë paraqitur prova se dëmi ka ndodhur me fajin e të Paditueses.

Gjykata Komunale e Deqanit, në aktgjykimin e saj C. nr. 237/2004, të datës 11 prill 2008, e ka miratuar pjesërisht padinë e Paditësit dhe e ka obliguar të Padituren që ti paguaj shpenzimet për shtëpinë e shkatërruar në shumë prej 6, 564.20 Euro dhe për instalimet e dëmtuara të rrymës në shumë prej 675 Euro, e të dyja këto me kamatë ligjore nga 17 gushti 2004 deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 787.80 Euro. Gjykata Komunale ka konstatuar se shtëpia e Paditësit ka qenë e kyçur me sistemin e rrymës elektrike me tension të ulët e cila qeverisej nga e Paditura. Zjarri në shtëpinë e Paditësit ka ardhur si pasojë e tensionit jashtëzakonisht të lartë në sistemin e rrymës. Gjykata Komunale ka konsideruar se dëmi material ndaj të Paditurit ishte shkaktuar për arsye të materialit apo aktivitetit të rrezikshëm në posedim dhe kontroll të së Paditueses. Konform Nenit 185, lidhur me Nenet 154 (2), 173 dhe 174 të Ligjit mbi Obligimet (1978), Gjykata Komunale ka konkluduar se e Paditura është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara ndaj Paditësit.

Gjykata Komunale, poashtu, ka dhënë edhe këshillën juridike se ankimi ndaj vendimit të saj do të duhej të paraqitet në DHPGJS, përmes Gjykatës Komunale brenda 15 ditëve nga dorëzimi i aktgjykimit.

III

Me 30 maj 2008, e Paditura ka paraqitur ankim ndaj aktgjykimit të lart-cituar, dhe ka kërkuar që ai të anulohet dhe padia të refuzohet si e pabazuar, ose që ta kthejë lëndën në Gjykatën Komunale për rigjykim. Ankimi bazohej në shkeljet e deklaruara të dispozitave të Ligjit mi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e SFRJ-së 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596, tani e tutje si LPK), në vërtetim jo të plotë dhe të pasaktë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Pastaj, e Paditura ka cekur se Gjykata Komunale nuk i ka marrë parasysh deklaratat dhe mendimet me shkrim të ekspertëve-dëshmitarë.

Paditësi nuk iu ka përgjigjur ankimit.

Me aktgjykimin e tij të datës 2 prill 2009, SCA-08-0072, Trupi Gjykues e ka refuzuar ankimin si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deqan, C nr. 237/2004 të datës 11 prill 2008. Trupi Gjykues ka konsideruar se aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk përmban asnjë shkelje thelbësore të Nenit 354 të LPK-së, dhe se Gjykata Komunale e ka bazuar drejtë aktgjykimin e vet mbi faktet e vërtetuara dhe konkluzionet e paraqitura prej të dy ekspertëve-dëshmitarë. Pastaj, Trupi Gjykues iu ka referuar rëndesës së provave lidhur me përgjegjësinë objektive të së Paditures dhe ka konstatuar se në ato rrethana, gjykata e shkallës së parë ka sjellë argumente të mjaftueshme dhe dëshmi të forta në mbështetje të aktgjykimit të saj. Pos kësaj, Trupi Gjykues nuk ka gjetur parregullsi lidhur me marrjen në pyetje të ekspertëve-dëshmitarë.

Aktgjykimi i Trupit Gjykues i është dërguar të Paditures me 6 maj 2009; me 5 qershor 2009 e Paditura ka paraqitur ankim ndaj tij pranë Kolegjit Ankimor të DHPGJS-së.

Ankimi para Kolegjit Ankimor:

E Paditura kërkon nga Kolegji Ankimor që ta rishqyrtojë aktgjykimin e Trupit Gjykues dhe ta refuzojë padinë e Paditësit si të pabazuar, që ta anulojë aktgjykimin e Trupit Gjykues dhe ta kthejë lëndën në Gjykatën Komunale për rigjykim.

IV

E Paditura e bazon ankimin e saj në Kolegjin Ankimor në shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së, në vërtetim jo të plotë dhe pasaktë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. E paditura konsideron se Trupi Gjykues nuk i ka marrë në konsideratë deklaratat dhe mendimet me shkrim të ekspertëve-dëshmitarë të prezantuara në mënyrë të drejtë në shkallën e parë.

Përgjigja pranë Kolegjit Ankimor:

Paditësi kërkon që të hedhet poshtë ankimi si i pabazuar dhe që të vërtetohet aktgjykimi i Trupit Gjykues.

Paditësi deklaron se Gjykata Komunale dhe Trupi Gjykues i DHPGJS-së nuk kanë bërë shkelje thelbësore të dispozitave të LPK, se ato e kanë vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe se nuk i kanë shkelur dispozitat e së drejtës materiale.

Arsyetimi Ligjor:

Shtrirja e Procedurës Ankimore

Sipas Nenit 4.3 të RREG së UNMIK-ut 2008/4 aktgjykimi apo aktvendimi i gjykatës të cilës iu ka dërguar lënda nga Trupi Gjykues i DHPGJS-së konform Nenit 4.2 mund të ankimohet vetëm pranë Trupit Gjykues të DHPGJS-së, përveç nëse Trupi Gjykues vendosë ndryshe në pajtim me rregullat procedurale të shpallura sipas Nenit 7. Neni 4.4 zbatohet për çdo aktgjykim pasues të lëshuar nga Trupi Gjykues. Sipas Nenit 4.4. Kolegji Ankimor ka jurisdiksion të veçantë për të vendosur mbi ankimet kundër ndonjë aktgjykimi apo aktvendimi të Trupit Gjykues të DHPGJS-së, pos nëse parashihet ndryshe me këtë rregullore. Neni 9.5 parasheh se nëse një aktvendim, përfshirë edhe aktgjykimin e lëshuar konform Nenit 4.3, ankimohet Kolegji Ankimor së pari përcakton se nëse aktvendimi apo aktgjykimi i ankimuar i Trupit Gjykues meriton rishqyrtim Nëse Kolegji Ankimor vendos që mos ta rishqyrtojë aktvendimin apo aktgjykimin e Trupit Gjykues të lëshuar konform nenit 4.3, aktgjykimi apo aktvendimi i tillë bëhet i plotfuqishëm. Nëse Kolegji Ankimor e rishqyrton aktvendimin apo aktgjykimin ai mund të vendos që ta vërtetoi, anulojë apo ndryshojë aktgjykimin apo aktvendimin e marrë nga Trupi Gjykues.

Duke marrë në konsideratë përmbajtjet e Neneve 4.3, 4.4 dhe 9.5 të RREG së UNMIK-ut 2008/4, shihet se dëshira e ligjvënësit ka qenë që në lëndët e referuara në të cilat Trupi Gjykses ka marrë vendim si shkallë e dytë dhe Kolegji Ankimor është shkalla e tretë, Kolegji i Ankimor së pari përcakton se nëse aktvendimi apo aktgjykimi i ankimuar meriton revizion.

RREG e UNMIK-ut 2008/4 dhe UA i UNMIK-ut 2008/6, nuk përmbajnë dispozita tjera të veçanta lidhur me pyetjen se kur revizioni, siç parashihet me Nenin 9.5 të RREG së UNMIK-ut lejohet. Kësaj pyetje mund përgjigjemi duke marrë në konsideratë dispozitat e LPK-së, në zbatim sipas Nenit 70.3 pika a) e UA-së së UNMIK-ut 2008/6 i cili thotë: *"Gjatë interpretimit të kësaj Urdhërese administrative ose gjatë seancës për ndonjë çështje e cila, sipas gjykimit të saj, nuk është zgjidhur në mënyrë të duhur sipas kësaj Urdhërese administrative, Dhoma e Posaçme mund të marrë parasysh, me ndryshimet dhe kufizimet që i konsideron të domosdoshme ose të përshtatshme në ato rrethana: cilëndo dispozitë të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore që zbatohet në Kosovë, dhe cilëndo dispozitë të ligjit në fuqi për kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës që ka të bëjë me çështjet civile."* Neni 382, paragrafi 1 i LPK-së parasheh "revizion" të aktgjyqimeve të shkallës së dytë. Sipas Nenit 385 të LPK-së mjeti ligjor i jashtëzakonshëm, "revizioni" mund të zbatohet 1) për shkak të shkeljes së praktikës dhe procedurës sipas Nenit 354, paragrafi 2 i LPK-së me disa përjashtime 2) për shkak të ndonjë shkelje të praktikës dhe procedurës të përshkruar në Nenin 354, paragrafi 1 i LPK-së lidhur me procedurat para gjykatës së shkallës së dytë dhe 3) për shkak të shkeljeve të ndonjërës nga dispozitat e së drejtës materiale. Veçmas, është përcaktuar se procedura e revizionit nuk lejon kundërshtimin e rezultateve reale të fakt-gjetjes. Këto dispozita të LPK-së si të tilla, duhet thënë qartë, nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme, por ato mund të merren si udhërrëfyes për të vendosur në pyetjen se si të interpretohen fjalët "meriton revizion" në Nenin 9.5 të RREG së UNMIK-ut 2008/4". Duke shfrytëzuar *ratio legis*-in e këtyre dispozitave ankimi meriton revizion kur shkelja e ndonjërës nga parimet e përmendura duket të mos jetë *in principio* e pamundshme nga pandehjet e thëna nga Ankuesi në lidhje me aktvendimin e marrë nga gjykata e shkallës së dytë. Shtrirja e jurisdiksionit të Kolegjit Ankimor të DHPGJS-së, si gjykatë e shkallës së tretë në të njëjtën kohë kufizohet në shqyrtimin më kujdes të aktvendimit të shkallës së dytë sa i përket shkeljes së ligjit, pra pa e krijuar shkallën e tretë fakt-gjetëse.

Kërkesat e të Paditues në ankim se Neni 354, paragrafi 2, pika 13 i LPK-së është shkelur për arsye se "ai është i pakuptimtë, dhe se diapozitivi bie në kundërshtim me arsyetimin e dhënë, gjersa kjo e fundit nuk përputhet me dokumentet provuese të kësaj lënde".

VI

Për më tepër, e Paditura pohon se ka vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse "nuk është e qartë se në cilën provë dhe/ose ekspertizë gjykata e bazon vendimin e saj, meqë ekspertizat janë në kundërshtim me njëra tjetrën". Si rrjedhojë, e Paditura konsideron se gjykata gjithashtu e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Nga thëniet e cituara më lart të së Pasditures lidhur me aktgjykimin e Trupit Gjykses duket e pamundshme se ka patur shkelje të së drejtës materiale gjatë marrjes së aktgjykimit të kundërshtuar.

Sidoqoftë, çështja se nëse aktgjykimi i Trupit Gjykses përmban gabim sepse Trupi Gjykses nuk i ka kushtuar kujdes ex officio mungesës së mundshme të juridiksionit lëndor të Gjykatës Komunale të Deqanit rreth padisë së Paditësit. Kolegji Ankimor konsideron se aktgjykimi i Trupit Gjykses pjesërisht meriton revizion për këto arsye:

Juridiksioni i Gjykatës Komunale për padinë

Sipas Nenit 354, paragrafi 2, pika 3 e LPK-së shkelja thelbësore e ligjit sa i përket praktikës dhe procedurës gjithmonë deklarohet kur një aktvendim është marrë mbi ndonjë lëndë e cila nuk ka qenë nën juridiksionin e asaj gjykatë (Neni 16) Neni 16 parasheh gjatë gjithë procedurës detyra zyrtare e gjykatës është që të kujdesët se nëse zgjidhja e kontestit bie nën juridiksionin e saj.

Në kohën kur është paraqitur padia, juridiksioni i DHPGJS-së ishte definuar në Nenin 4 të RREG së UNMIK-ut 2002/13. Neni 4.2 i RREG së cituar përcakton se asnjë gjykatë në Kosovë nuk do të ushtrojë juridiksion mbi paditë apo të gjykojë lëndë ku përfshihen lëndët siç përkrahjet në Nenin 4.1, përveç se nëse ato padi apo çështje iu kanë ceduar asaj në pajtim me këtë Nen. Pastaj, Neni 4.1, pika c) përcakton se paditë, përfshirë edhe paditë kreditore apo pronësore, të paraqitura kundër ndonjë ndërmarrje apo korporate tani apo më parë nën kompetencën administrative të Agjencisë, nëse ato padi janë paraqitur gjatë apo para periodës kohore kur ajo ndërmarrje apo korporatë është apo ka qenë nën kompetencën administrative të Agjencisë, bijnë nën juridiksionin e DHPGJS-së. Sipas definicionit të dhënë në Nenin 3, "ndërmarrja" e ka kuptimin e definuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12.

VII

Neni 5.1 i RREG së UNMIK-ut 2002/12 saktëson se Agjencia do të ketë kompetencë për ti administruar ndërmarrjet publike dhe ato shoqërore që janë regjistruar apo operojnë në territorin e Kosovës dhe asetet e tyre gjenden në territorin e Kosovës.

Sipas Nenit 17.1 pika b) të UA-së së UNMIK-ut 2003/13 (e poashtu Neni 15.1 pika b e UA-së së UNMIK-ut 2008/6), DHPGJS mundet, më kërkesë të palës apo me propozim të saj, ti cedojë disa padi specifike apo pjesë të saj tek gjykata e cila e ka jurisdikcionin e duhur lëndor sipas ligjit në zbatim, kur DHPGJS sigurohet se gjykata së cilës padia i cedohet do të bjen vendim të paanshëm, duke patur parasysh (i) natyrën e palëve, (ii) vlerën e shumës në kontest dhe (iii) rrethanat tjera të padisë.

Në këtë lëndë, Paditësi ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komunale të Deqanit kudër të Paditures, si ndërmarrje publike. Sipas dispozitave të sipër-cituara, Gjykata Komunale nuk ka patur jurisdikcion mbi padinë e Paditësit, meqë DHPGJS-ja nuk ia ka ceduar asaj lëndën. Pa cedim nga ana DHPGJS-së, Gjykata Komunale nuk është dashur ta shqyrtojë padinë. Mungesa e jurisdikcionit mbi padinë e Paditësit është dashur të merret në shqyrtim ex officio nga gjykata e shkallës së parë e poashtu edhe nga Trupi Gjykues i DHPGJS-së.

Mirëpo, bazuar në faktet jokontestuese të lëndës mund të thuhet ex post, se kushtet për cedim të padisë në Gjykatën Komunale do të plotësoheshin poqese padia të paraqitej drejtë në DHPGJS e pastaj ajo do të ishte bërë objekt i cedimit. Pas një cedimi të tillë, Gjykata Komunale do të kishte jurisdikcion mbi padinë e Paditësit dhe se ankimi do të duhej të paraqitej, siç në fakt ishte, pranë DHPGJS-së. Mund të shihet se në rastin konkret procedura do të kishte qenë e njëjtë po qe se lënda iu kishte ceduar më herët Gjykatës komunale. Në këtë rrethanë specifike, nuk ka nevojë që të rifillohet e tërë procedura duke prishur aktgjykimin e Trupit Gjykues dhe duke e urdhëruar atë që ta shqyrtoi lëndën si gjykatë e shkallës së parë (me rezultatin më të mundshëm për cedim të ri). Ratio legis-i i dispozitave të lartpërmendura lidhur me jurisdikcionin e DHPGJS-së është plotësuar, meqë lënda është shqyrtuar nga DHPGJS-ja në të njëjtën mënyrë sikur që do të shqyrtohej po të ishte paraqitur në DHPGJS që në fillim. Në këtë aspekt, gjithashtu është marrë parasysh se padia e Paditësit ka pritur zgjidhe para gjykatave afërsisht për katër vite dhe se përsëritja e procedurës do të nënkuptonte se e drejta e palëve për gjykim të lëndës brenda afatit të arsyeshëm me siguri do të shkelej.

VIII

Si rrjedhim i arsyetimit të dhënë më lart, vendimi i Gjykatës Komunale mbetet në fuqi.

Gabimi i Gjykatës Komunale në këshillë juridike.

Në këshillën juridike, bashkëngjitur në aktgjykim të Gjykatës Komunale, thuhet se "lejohet ankimi kundër këtij aktgjykimi pranë DHPGJS, nëpërmes kësaj gjykate, brenda 15 ditëve nga dorëzimi i këtij aktgjykimi".

Sipas Nenit 56.1 të UA-së së UNMIK-ut 2006/17 i zbatueshëm në at kohë, afati për paraqitje të ankimit ka qenë dy muaj nga dorëzimi i vendimit tek palët. Ankimi është dashur të paraqitej drejtpërdrejt në Dhomen e Posaçme, e jo përmes Gjykatës Komunale. Kjo duhet të merret parasysh nga Gjykata Komunale në rastet tjera para saj.

Këshilla juridike në aktgjykimin e Trupit Gjykues.

Pika III e diapozitivit të aktgjyimit të kundërshtuar duhet të eliminohet pa zëvendësim, meqë udhëzimet për paraqitje të ankimit duke cituar ligjin pa ndonjë liri veprimi të gjykatës, nuk janë vendime dhe kështu nuk mund të futen në diapozitiv. Informacioni i tillë mund të epet brenda arsyetimit ligjor ose –disi ti bashkëngjitet vetëm vendimit, por nuk mund të jetë pjesë e diapozitivit (shih ASC-09-0108, etj).

Shpenzimet

Në bazë të Nenit 11 të RREG 2008/4 dhe Nenit 66 të UA-së së UNMIK-ut 20078/6, Trupi Gjykues duhet të vendosë në caktimin e shpenzimeve të procedurës në shkallën ë e parë, dhe se Kolegji i Ankimor – kur ta vendosë lëndën përfundimisht - rreth caktimit të shpenzimeve të procedurës në të dyja shkallët.

IX

Në procedurën e Trupit Gjykues, Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje ndaj ankimit të së Paditures andaj edhe nuk ka shpenzime.

Në procedurën e Kolegjit ankimor, Paditësi ka paraqitur përgjigje ndaj ankimit të së Paditures. Paditësi më nuk përfaqësohej nga ndonjë avokat, por përfaqësonte vetveten. Andaj, Paditësi nuk ka patur shpenzime në procedurën e Kolegjit Ankimor.

Me 13 nëntor 2009, Paditësit i është lejuar ndihma në përkthim. Në emër të Paditësit, janë përkthyer tri faqe në Anglisht nga DHPGJS. Sipas Rregullave Plotësuese Procedurale të DHPGJS-së lidhur me shpenzimet gjyqësore, në fuqi prej 10 marsit 2010(në bazë të Nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6) shpenzimet në përkthim janë 12 (dymbëdhjetë) Euro për faqe dhe kjo e bënë shumën prej 36 Euro. Shpenzimet në përkthim të lutjeve duhet kuptuar si pjesë të shpenzimeve gjyqësore.

Sipas Rregullave Plotësuese Procedurale të DHPGJS-së lidhur me shpenzimet gjyqësore, bazuar në vlerën e padisë (6, 564.20 +675 = 7, 239.20 Euro) aplikohen këto tarifa gjyqësore për procedurën e ankimit (shih ASC-09-0072 etj):

Tarifa e Taksës Gjyqësore, Neni 10.11 (parashtrimi i ankesës)..30 Euro

Tarifa e Taksës Gjyqësore Neni 10.1 lidhur me 10.22
(vendimi në shkallën e tretë)..... 100 Euro

Gjithsej.....130 Euro

X

Pala e pasuksesshme, e Paditura, obligohet ti paguaje në DHPGJS shpenzimet e përkthimit për lutjet e Paditësit në procedurën ankimore (36) Euro dhe shpenzimet gjyqësore (130 Euro), gjithsej 166 Euro.

Richard Winkelhorf,
Gjyqtar Kryesues, EULEX

(nënshkrimi)

Torsten Koschinka,
Gjyqtar, EULEX

(nënshkrimi)

Elija-Liisa Helin,
Gjyqtare, EULEX

(nënshkrimi)

Tobias Lapke,
Regjistruer, EULEX

(nënshkrimi)